



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 595/2020  
Datë: 24 nëntor 2020

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 36 paragrafi 2, 3 dhe 5 të Rregullores Nr.07/2015 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit si dhe në bazë të Vendimit KPK/Nr.575/2020, në takimin e mbajtur me datë 24 nëntor 2020, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Z. Petrit Kryeziu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, ka kaluar me sukses mandatin fillestar tre (3) vjeçar, dhe i njëjti i propozohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dekretim me mandat të përhershëm.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

**Arsyetim**

Sipas Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr. DP-008-2018, të datës 22 janar 2018, i cili i referohet Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës Nr.650/2017, të datës 28 dhjetor 2017, z. Petrit Kryeziu, është emëruar prokuror me mandat fillestar tre (3) vjeçar.

Pas vlerësimit pozitiv të punës së prokurorit Kryeziu për periudhën e kaluar tre (3) vjeçare, i propozohet Presidentit të Republikës së Kosovës, që z. Petrit Kryeziu të dekretohet prokuror me mandat të përhershëm.

Bahri Hyseni  
  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
- Z. Petrit Kryeziu, prokuror në P.Th. Prizren;
- Sekretariatit dhe NJSHPP, dhe
- Arkivit të KPK-së.